



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.55/2016

Prishtinë, më 26.4.2016, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi, Haxhi Qerkini, Fazlie Bekteshi dhe Deniza Shabanaj, MZHE; Ali Hamiti, ekspert; Dardan Abazi, INDEP; Dren Ajeti, GLPS; Fjolla Uka, KDI dhe Evlina Kabashi, praktikante e Komisionit.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 dhe 21.04.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, propozoi që të shtohet edhe një pikë e re e rendit të ditës: shqyrtimi i Listës së kandidatëve të propozuar nga Qeveria lidhur me bordin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisionin u pajtua me këtë propozim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 dhe 21.04.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 19.4.2016, u miratua me këtë plotësim nga kryetari i Komisionit, **z. Muhamet Mustafa,** të faqja e katërt të shtohet ky tekst:

“Te diskutimi i z. Sasha Milosavleviq të shtohet se nuk do t’i votojë amendamentet e grupit punues dhe as ligjin, ndërsa te unë të shtohet aty ku është rreshti se duhet të merret pëlqimi komunave të zëvendësohet “të marrin pjesë komunat”.

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 21.04.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike

Kryetari tha se për Projektligjin për energjinë elektrike, grupi i punës ka angazhuar ekspertin, profesor Ali Hamitin dhe e ka shqyrtuar, analizuar dhe i ka hartuar amendamentet. Kryesues i grupit të punës ka qenë z. Besim Beqaj, të cilit ia dha fjalën.

Besim Beqaj tha se amendamentet i keni marrë, ndësa një temë që ka mbetur diskutabile ka qenë te neni 13, te Bordi i drejtorëve dhe një çështje tjetër të neni 11, shthurja e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, kompetencë e të cilit institucion do të mbetet. Lidhur më këto çështje, do të marrim sqarimet e nevojshme nga përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sepse ka qenë konkluzion i grupit të punës që ministria të sjellë propozimin e ri.

Sabit Gashi, Ministria e Zhvillimit ekonomik, tha se Kosova është Palë Kontraktuale e Komunitetit të Energjisë sipas Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë. Më 6 tetor 2011, Këshilli Ministror, i cili është organi më i lartë vendimmarrës i Komunitetit të Energjisë, ka marrë Vendim që obligon të gjitha shtetet Kontraktuale të transponojnë direktivat dhe Rregulloret si vijon: Direktiva 2009/72/EC për tregun e brendshëm të energjisë elektrike; Direktiva 2009/73/EC për tregun e gazit natyror; Rregullorja 714/2009/EC për rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike; Rregullorja 715/2009/EC për rrjedhat ndërkufitare të gazit natyror. Sipas Vendimit të Këshillit Ministror transpozimi ka afatin e përfundimit deri më 1 janar 2015 dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Për të përmbushur dispozitat e Nenit 114 të MSA-së, që nënkupton zbatimin e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, në rastin konkret, është e nevojshme të përcaktohen në ligj dispozita për kontrollin e

Operatorit të Sistemit të Transmisionit nga personi që nuk është i njëjti me atë që kontrollon gjenerimin. Vonesat në dergimin e legjislacionit të përgatitur kanë ardhur si rezultat i zgjedhjeve të vitit 2014, që janë përcjellë me vonesa për themelimin e Qeverisë. Përgatitja e legjislacionit është bërë në bashkëpunim të ngushtë edhe me Ekspertët e Sekretariatit të Komuniteti të Energjisë, të cilët kanë dhënë vlerësim pozitiv në draftin final të dokumenti që është dërguar në Qeverinë e Kosovës, në dhjetor të vitit 2015, i cili është lexuar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës. Çështje problematike për transpozimin e kërkesës së Direktivës Evropiane në Projekt- Ligjin për Energjinë Elektrike, është dispozita që ka të bëjë me shthurjen pronësore të Operatorit të Sistemit të Transmisionit nga aktiviteti energjetik të Gjenerimit dhe Furnizimit. Shthurja e aktivitetit të Transmetimit të energjisë elektrike nga gjenerimi dhe furnizimi është kusht për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Pra, shthurja pronësore e KOSTT është parakusht për certifikimin e KOSTT, si Operator i Sistemit të Transmisionit nga ZRRE, dhe rrjedhimisht pjesëmarrja e KOSTT në mekanizmat rajonal mund të vihet në pikëpyetje nëse KOSTT nuk certifikohet, dhe angazhimi shumëvjeçar i të gjitha palëve të interesit për pavarësimin energjetik të Kosovës mund të vihet në pikëpyetje. Konsiderojmë se për disa arsye që lidhen me natyrën e punës së OST-së, konsolidimin shumë të mirë të tij, monitorimin në baza të përditshme të tij në shumë elemente vitale nga ZRRE, si agjenci e fuqishme rregullatore, detyrimet që do të ketë OST ndaj ENTSO-E në të ardhmen, janë disa argumente që na kanë çuar drejt propozimit që OST të kontrollohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke i lënë edhe të qeverisin rolin, për të ngritur shqetësimet e veta në lidhje me aspekte të zbatimit të politikave të sektorit të energjisë.

Kryetari, pastaj, e prezantoi secilin amendament veç e veç dhe e hodhi në diskutim e votim, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 3, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 5, nënparagrafi 1.3. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 5, nënparagrafi 1.4. riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 5, paragrafi 2 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 3, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 5, paragrafi 5 dhe 5.1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 5, paragrafi 8, riformulohet.

Sabit Gashi, Ministra e Zhvillimit Ekonomik, propozoi që në amendamentet aty ky është rregullatori të mbetet ashtu siç është në Projektligj Zyra e Rregullatorit për Energji.

Komisioni përkrahu propozimin e Sabit Gashit, por theksoj se duhet të shtohet një përkufizim i ri për ZRRE dhe mbulohet mandej amendamenti.

Amendamenti 8

Neni 7, nënparagrafi 1.11, fjalia “rregulloreve ndërkombëtare,” zëvendësohet me “aktet juridike ndërkombëtare” si dhe teksti “Informatat për orë/për central që duhet ruajtur,” zëvendësohet me “Informatat që duhet ruajtur për orë/për central,”
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 8, paragrafi 5, fjala “Ditribuiv” zëvendësohet me “Shpërndarjes”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 9, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 10, paragrafi 1, fjalia “udhëheq me pronën ” zëvendësohet me “mban në pronësi”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 11, paragrafi 4 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 11, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Pas nenit 12, shtohen tre nene të reja.

Sabit Gashi, Ministra e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me këto tri nene të reja, tha që janë hartuar sepse është dashur të formulohen në këtë mënyrë këto tre nene, pasi që është kërkuar nga Komuniteti për Energji, siç e arsyetova më lart.

Kryetari sqaroi së Bordin e KEK-ut e zgjedh dhe e mbikëqyrë Qeveria, ndërsa Bordin “KOSTT-it” e zgjedh dhe e mbikëqyrë Kuvendi.

Besim Beqaj tha se pajtohet me këtë formulim pasi që është i domosdoshëm.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 13, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 14, nënparagrafi 2.2 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 14, nënparagrafi 2.9 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 14, nënparagrafi 2.11 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 16, nënparagrafi 1.1 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 16, paragrafi 2 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 16, paragrafi 4, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 17, paragrafi 1, fshihet fjalia “te të cilat vjen”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 18, paragrafi 2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 18, paragrafi 3, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 19, paragrafi 5, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 19, paragrafi 10, fjala “Transmisionit” zëvendësohet me “Tregut”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 19, fshihen nënparagrafët 9.16;9.17; 9.18 dhe 9.23.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28

Neni 24, paragrafi 1, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29

Neni 24, nënparagrafi 6.5, shprehja “në të cilin” zëvendësohet me “ku”, si dhe paragrafi 7, fjala “kompanisë” zëvendësohet me “ndërmarrjes”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30

Neni 25, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31

Neni 27, paragrafi 3, fjala “revidohen” zëvendësohet me “rishikohen”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32

Neni 30, paragrafi 1, shprehja “të konsumatorëve” zëvendësohet me “te konsumatorët”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33

Neni 30, paragrafi 5, fshihet teksti “përfshirë blerjen nëpërmjet importeve”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34

Neni 31, nënparagrafi 2.4, fshihet teksti “jo më shumë se”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35

Neni 31, nënparagrafi 2.7.5, ndryshohet afati nga “6 (gjashtë) javë” me “21 (njëzet e një) ditë”.

Sabit Gashi, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, propozoi që afati nga “ 21 (njëzet e një) ditë” të bëhet “ 45 (dyzet e pesë) ditë”.

Komisioni përkrahu amendamentin 35 më propozimin e Sabit Gashit.

Amendamenti 36

Neni 31, nënparagrafi 2.8.6, fjala “konsumatorëve” kalon në njëjës dhe bëhet “konsumatorit”, dhe kjo vlen për të dy rastet e përdorimit në këtë nënparagraf.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37

Neni 32, paragrafi 2, fjala “liferimit” zëvendësohet me “livrimit”, dhe kjo vlen në tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38

Neni 33, paragrafi 5, fjala “prapambetur” zëvendësohet me “mbetur”, dhe, po ashtu, në këtë paragraf fshihet teksti i përsëritur “në vendosjen e kushteve”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 39

Neni 33, paragrafi 7, fshihet teksti “me procedurë të shpejtë”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40

Neni 37 dhe 38, në titullin e këtyre neneve dhe në tekstin e neneve shprehja “furnizues garantues” zëvendësohet me “furnizues i mundësisë së fundit”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41

Neni 37, paragrafi 4, referenca “ në pajtim me nenin ... të këtij ligji” zëvendësohet me “ në pajtim me nenin 5 të këtij ligji”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 42

Neni 45 ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43

Neni 53, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44

Neni 54 ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45

Neni 55, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 46

Neni 56, paragrafi 2, fshihet teksti “dhe Operatori i Tregut”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 47

Neni 57, paragrafi 2, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 48

Neni 58, nënparagrafi 1.6, referenca “në paragrafin 7 të këtij neni” zëvendësohet me “në paragrafin 1.7 të këtij neni”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 49

Neni 58, paragrafët 2 dhe 3, teksti “përveç siç është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni ” zëvendësohet me “me përjashtim në rastet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 50

Neni 59, paragrafi 3 fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 51

Neni 59, paragrafi 6, ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 52

Neni 59, pas paragrafit 9 shtohet paragraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike.

2. Raporti t'iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror

Kryetari theksoi se, po ashtu, edhe për Projektligjin për Gazin Natyror, grupi i punues, së bashku me ekspertin, e ka shqyrtuar, analizuar dhe i ka hartuar gjithsej 54 amendamente në mungesë të kryesuesit të grupit të punës. Këtë e ka kryesuar anëtari i grupit të punës, z. Blerim Grainca, të cilit ia dha fjalën.

Blerim Grainca tha se grupi i punës së bashku me ekspertin, stafin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe stafin e Komisionit e ka shqyrtuar nën për nën Projektligjin për Gazin Natyror, dhe të gjitha amendamentet janë harmonizuar me projektligjin.

Kryetari, pastaj, e prezantoi secilin amendament, veç e veç, dhe e hodhi në diskutim e votim, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 1, fjala “transmission” zëvendësohet me “trasmetim” dhe fjala “deponimin” në “depozitim/in” dhe kjo vlen për tërë projektligjin.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 3, paragrafët 1 dhe 2, fjala “Shprehjet” zëvendësohet me “Termat”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.1, fjala “kontestini” zëvendësohet me “kontekstin” dhe kjo vlen në tërë tekstin ku paraqitet për këtë kuptim.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 3, nënparagrafi 1.2, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 3, nënparagrafët 1.6 dhe 1.7, fjala “shtëpiak” zëvendësohet me “familjar” dhe “joshtëpiak” zëvendësohet me “jofamiljar” dhe kjo vlen për projektligjin.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.10, fjalia “I cënueshëm” zëvendësohet me “në nevojë” dhe kjo vlen për projektligjin.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 3, nënparagrafi 1.13 riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 3, nënparagrafi 1.14, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 3, nënparagrafi 1.21, pas fjalës “transmisionit” shtohet fjalia “ dhe depozitimit”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 3, pas nënparagrafi 1.23, shtohet një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 3, nënparagrafi 1.25, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 3, nënparagrafi 1.27, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 3, nënparagrafi 1.29, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 3, nënparagrafi 1.29, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 3, nënparagrafi 1.33, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 3, nënparagrafi 1.36, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 3, nënparagrafit 1.43, shtohet edhe një nënparagraf i ri.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 4, fjalia “Zyrën e Rregullatorit për Energji” zëvendësohet me “Zyrën e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme Rregullatori).”
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 4, nënparagrafi 1.7, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 4, nënparagrafi 2.5, fjala “rregulloret” zëvendësohet me “legjislacionin”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 6, fjala “implementimin” zëvendësohet me “zbatimin” dhe ky ndryshim vlen për tërë projektligjin.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 7, paragrafi 5, fjala “leferimin” zëvendësohet me “livrimin” dhe ky ndryshim vlen për tërë projektligjin.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 7, paragrafi 7, fjala “kontraktuale” zëvendësohet me “kontraktuese” dhe ky ndryshim vlen për tërë projektligjin.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 8, titullit i shtohet fjalia “të furnizimit me gaz natyror”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26

Neni 10, paragrafi 2, fshihet fjalia “së paku një”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27

Neni 10, nënparagrafi 2.11. fshihet

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28

Neni 10, paragrafi 6, fjala “nën” zëvendësohet me “në”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29

Neni 10, paragrafi 12, teksti “dhe të njëjtat njoftohen te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.” Zëvendësohet me “dhe të njoftohen te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.”

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30

Neni 11, nënparagrafi 1.5 fshihet fjala “kosto”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31

Neni 11, nënparagrafi 7.3 fjalia “akte ligjore” zëvendësohet me “legjislacionin në fuqi”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32

Neni 13, paragrafi 2, fjala “respective” zëvendësohe me “përkatëse”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 33

Në Kapitullin II, shtohet fjala “DHE DEPOZITIMIT”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34

Neni 15, paragrafit 7, fjalia “në nenin 16 të këtij ligji.” zëvendësohet me “sipas këtij neni”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 35

Neni 15, paragrafit 8 fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 36

Neni 16, titullit i shtohet fjala “dhe depozitimit”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 37

Neni 16, paragrafit 1 fshihet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 38

Neni 18, nënparagrafi 1.3 fjala “interkonektuar” zëvendësohet me “ndërlidhur”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 39

Neni 22, nënparagrafi 7, fjalia “të këtij nënparagrafi,” zëvendësohet me “të këtij neni”. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 40

Neni 25, paragrafi 3, fjalia “reflektuese të kostos” zëvendësohet me “që reflektojnë koston”. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 41

Neni 26, nënparagrafi 2.5, fjalia “si dhe i njëjti publikohet” zëvendësohet me “i cili publikohet”. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 42

Neni 30, në titull fjala “energjetike” zëvendësohet me “të enërgjisë” dhe ky ndryshim vlen për tërë nenin. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 43

Neni 34, paragrafi 1, fjala “linjë gypore” zëvendësohet me “linjë të tubacioneve”. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 44

Neni 34, paragrafi 7, ndryshohet. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 45

Neni 36, nënparagrafi 1.3, fjalia “në sistemet e të cilëve” zëvendësohet me “ku”. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 46

Neni 36, pjesa e dytë e paragrafit 12, riformuohet. Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 47

Neni 36, pjesa e parë e paragrafit 14, riformulohet.

Raif Qela propozoi që amendamenti 47 të fshihet dhe të mbetet ashtu siç është në Projektligj, pasi që është shumë më mirë i definuar dhe paraqet një qartësi më të madhe.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Qela, që amendamentin 47 të fshihet.

Amendamenti 48

Neni 36, paragrafi 18, fjalia “nuk është bërë operacionale,” zëvendësohet me “nuk është lëshuar në punë”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 49

Neni 37, nënparagrafi 1.14, fjalia “kompromitimit” zëvendësohet me “komprometimit”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 50

Neni 42, paragrafi 4, lidhëza “nën” zëvendësohet me “me”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 51

Neni 43, paragrafi 2, fjala “kyçjen” zëvendësohet me “lidhjen” dhe kjo vlen për tërë projektligjin.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 52

Neni 44, paragrafi 2, fjala “sado” zëvendësohet me “sa”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 53

Neni 50, nënparagrafi 4.7, fshihet fjalia “e tilla,”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 54

Neni 51, paragrafi 2, bëhet nen në vete, i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

1. Miratohet Raporti me amendamentet e Projektligjit nr.05/L-082 për Gazin Natyror.
2. Raporti t'iu procedohet komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës.

5. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve të propozuar nga Qeveria lidhur me bordin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Kryetari tha se siç u njoftova, Komisioni duhet në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, ta shqyrtojë Listën e kandidatëve për anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të propozuar nga Qeveria, më 20 prill 2016, Nr. 08/85 dhe Nr. 07/73. Ai theksoi se në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në aspektin ligjor kandidatët i plotësojnë kushtet, por në aspektin ekspertizës do të ishte më mirë sikur ndonjëri prej këtyre kandidatëve të kishte përvojë pune në biznes dhe në konkurrencë, pasi i plotësojnë kushtet formale. Ne, si Komision funksional, jemi të obliguar t'i procedojmë për miratim në seancë plenare, në Kuvend.

Besim Beqaj tha se sa i përket aspektit ligjor duhet të jemi në harmoni me ligjin dhe kjo është përgjegjësi e Zyrës Ligjore të Qeverisë dhe Drejtorisë ligjore të Kuvendit, se a i plotësojnë kushtet formale. Mirëpo në aspektin profesional duhet të jemi ne, si Komision Funksional, t'i vlerësojmë se a i plotësojnë kushtet. Ai theksoi se sa i përket kandidateve i pashë në CV-it e tyre se vetëm njeri i kishte pak përvojë punë në konkurrencë, ndërsa të tjerët jo, prandaj nuk kanë përgatitje profesionale në biznes dhe konkurrencë, për këtë i kam dilemat.

Raif Qela tha se Autoriteti i Konkurrencës, si një institucion i rëndësishëm për rregullimin e tregut të Kosovës, që pesë vjet nuk është funksional, dhe si i tillë i ka shkaktuar dëme të mëdha tregut të Kosovës. Mundësitë për krijim të monopolit kanë qenë shumë të mëdha dhe ato mundësi janë shfrytëzuar, andaj ka pasur dëme të madh për shkak të mungesës së këtij Autoriteti. Prandaj për kundër faktit që është vonuar goxha shumë e përshëndes Qeverinë që e ka proceduar listën me kandidat për Bordin e Komisionit të Konkurrencës, por kjo nuk mjafton. Duke qenë se ky është institucion tepër i rëndësishëm që rregullon tregun nga rreziqet për krijim të monopolit, qoftë përmes sistemit klasik apo të kartelave, megjithatë unë, për hir të kësaj nuk do të votoj kundër kësaj përbërje, por kjo nuk mjafton që unë të votoj për. Arsyeja është kjo, ashtu siç e kemi thënë edhe për Bordet e tjera të Agjencive, për kundër faktit se është në mënyrë ligjore, sjellja në pako anëtarëve të bordeve, sjell këto pasoja, nuk kemi mundësi të përzgjedhim. Mendoj sikur të kishim pasur mundësi të përzgjedhjes do ta kishim pasur më të lehtë të votojmë për njërin apo tjetrin, por kjo përzgjedhje nuk më mjafton që të votoj për, pasi që nuk jam kënaqur më përgatitjen profesionale dhe nuk e kanë kreditin moral për të cilit do të ishim siguruara se nuk do të kishin ndikimin nga politika, prandaj ju, si Komision, vendosni si të doni, vota e ime do të jetë abstenim.

Fatmir Rexhepi tha se i kam dilemat e mia, pasi që këtë institucion e presin shumë punë dhe kjo përbërje e propozuar pa përgatitje profesionale në këtë sektor nuk ka mundësi me kryer më sukses këtë punë. Andaj, rekomandimi për Kuvendin, duhet të jetë në mungesë të eksperiencës që janë specifikat që i ka kjo fushë dhe përvoja e punës që iu mungon t'i kthehet Qeverisë kjo listë e propozuar, në mënyrë që mund t'i sjellë kandidatët më të përgatitur më profesionalisht në këtë fushë. Z. Rexhepi, theksoi se me të vërtetë ky institucion ka shumë punë për të bërë, prandaj funksionalizimi i këtij autoriteti duhet të këtë një përbërje shumë më profesionale për të mbuluar këtë fushë që është në tregun e Kosovës shumë e ndishme dhe rëndësishme.

Sasha Milosavleviq tha se në bazë të Listës së propozuar nga ana Qeverisë për kandidatet për anëtarë të Bordit Komisionit të Konkurrencës po shihet se i plotësojnë kushte formale dhe kanë bazën ligjore. Por në bazë të CV-ve të tyre është mirë t'i shikojmë së a është mirë të shkojnë për Kuvend, në seancën plenare më mbështetje apo pa mbështetje të Komisionit.

Blerim Grainca tha se pajtohet që disa nga kandidat nuk kanë përgatitjen profesionale sa përket fushës së konkurrencës dhe përvojës së punës në biznes. Por për Komisionin nuk është mirë që të shkojë më qëndrime të ndara për procedim në Kuvend dhe kërkoi që të gjindet një modus për rekomandimin për seancë plenare.

Fatmir Rexhepi potencoi se rekomandimi i Komisionit duhet me pasur një qëndrim korrekt, mbi bazën e asaj që kemi vlerësuar në aspektin profesional të fushës së konkurrencës dhe Kuvendit nuk i intereson vota, por a është në gjendje që Bordi i Komisionit të Konkurrencës ta mbulojë këtë sektor, duke e mos lejuar krijimin e monopolit në treg. Ky duhet të jetë arsyeja e rekomandimit për Kuvendin, pasi që për detyrat dhe peshën që ka Autoriteti i Konkurrencës dhe detyrat që presin, kjo listë më këta kandidat të propozuar nuk i plotësojnë kushtet.

Besim Beqaj potencoi së përvoja e punës nuk është e vetmja relevancë. Ne, si Komision Funkcional, nuk e marrim përgjegjësin në aspektin ligjor, siç e ceka më lart, por vetëm kriteret e vlerësimit profesional duhet t'i trajtojmë për këtë listë me këtë përbërje të propozimeve duke i rekomanduar Kuvendit në aspektin profesional, që në sektor të konkurrencës a i plotësojnë kushtet.

Sala Berisha- Shala tha se është mirë që ligjërisht dhe proceduralisht i plotësojnë kriteret për me proceduar më tutje. Ajo propozoi që Komisioni t'i procedojë për seancë dhe të ia lënë Kuvendit me vendos, dhe në rekomandim Komision me cekur së në aspektin profesional nuk është pajtuar më propozimet e listës së kandidateve për Bordin e Komisionit të Konkurrencës.

Kryetari tha se kjo përvojë profesionale iu mungon në biznes dhe konkurrencë, por në menaxhim të institucioneve kanë përvojë punë, çka do të thotë se i plotësojnë kushtet e parapara ligjore. Dhe arsyeja pse duhet që të vendosim që Kuvendit, t'ia paraqesim këtë listë është që sa më shpejt të behet funksionalizimi i bordit të komisionit të konkurrencës për vendimmarrje.

Pas debatit, Komisioni, 3 vota kundër, 2 për dhe dy abstenime, nxori këto:

R e k o m a n d i m

- 1. Të mos miratohet propozimi i Qeverisë për emërimin e kandidatëve në Bordin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës;*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa